



QENDRA SHQIPTARE PËR POPULLSINË DHE ZHVILLIMIN  
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT



**NE  
KËRKOJMË  
MË SHUMË**

Publikuar në Nëntor 2018,  
Tiranë, Shqipëri

NE KËRKOJMË MË SHUMË u krijua me anë të partnershipit ndërmjet UNESCO (Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara), IPPF (Federata Ndërkombëtare e Planifikimit Familjar) dhe The PACT. The PACT është një koalicion global i organizatave me fokus te të rinjtë udhëheqës dhe te shërbimi ndaj të rinjve, që punojnë së bashku për sigurimin e shëndetit, mirëqenies dhe të drejtave të të gjithë të rinjve, me fokus në shëndetin seksual dhe riprodhues, dhe dhënien fund të epidemisë së AIDS te të rinjtë. Një prioritet kyç i The PACT është garantimi i përgjegjësisë që kanë qeveritë në sigurimin e shërbimeve të integruara të HIV dhe shëndetit seksual, dhe në ofrimin e një edukimi seksual gjithëpërfshirës të një niveli të lartë.

[www.youthpact.org](http://www.youthpact.org)

Copyright The PACT, 2017.



# MIRËNJOHJE

Ky udhëzues është shkruar nga Federata Ndërkombëtare e Planifikimit Familjar (IPPF), me mbështetjen e një grupi pune pjesë e të cilit ishin organizatat e The PACT dhe, gjithashtu, të rinjtë vullnetarë të IPPF dhe organizatat partnere. Organizatat me të cilat kemi bashkëpunuar në përgatitjen e këtij udhëzuesi janë si më poshtë (rend alfabetik):

- Girls Awake Foundation;
- International Federation of Medical Students Associations;
- International Planned Parenthood Federation;
- Jamaica Youth Advocacy Network;
- Planned Parenthood Association of Ghana;
- Reproductive Health Uganda;
- Y-PEER;
- Youth Coalition on Sexual and Reproductive Rights;
- Youth RISE.

Falenderime të veçanta për Laura Hurley dhe Hayley Gleeson (IPPF), Sarah Hedges-Chou (Youth Coalition on Sexual and Reproductive Rights), Sharafdzhon Boborakhimov (Y-PEER), Akosua Agyemang (Planned Parenthood Association of Ghana), James Kato (Reproductive Health Uganda), dhe Genesis Luigi (IPPF – Rajoni i Hemisferës Perëndimore) për kontributin dhe komentet e tyre mbi këtë dokument. Falenderime, gjithashtu, ndaj Enrico Gianfranchi për dizejmin e kapakut të këtij udhëzuesi.



# PËRMBAJTJA

Prezantim .....	5
ESGJ: Bazat .....	6
Çfarë është ESGJ “I mirë”? .....	9
Avokaci 101 .....	14
Të ofrosh evidenca për ESGJ .....	15
Pyetjet më të shpeshta për ESGJ .....	16
Marrëveshjet Ndërkombëtare për ESGJ .....	18
Si të avokojmë në ESGJ .....	20
Përballja me Kundërshtimet .....	29
Burimet .....	32
Referencat .....	33



# PREZANTIM

Mirësevini në **“NE KËRKOJMË MË SHUMË”**: një udhëzues për avokimin e edukimit seksual te të rinjtë. Ky udhëzues është dizenuar për të rinjtë, të cilët duan të përmirësojnë edukimin seksual, që ofrohet në shkollat e tyre, qytetet ose shtetet.

Ti nuk ke nevojë të jesh një ekspert mbi edukimin seksual ose një “avokues” profesionist që të luftosh për një edukim më të mirë mbi çështjet e lidhura me seksualitetin, gjininë dhe marrëdhëniet. Ky udhëzues përfshin të gjithë informacionin dhe provat e nevojshme, që ju duhen për të argumentuar mbi rëndësinë e ofrimit cilësor të edukimit seksual gjithëpërfshirës (ESGJ) te të rinjtë. Jep këshilla sesi t'i bëjmë ndryshimet të ndodhin në vendin ku jetojmë dhe, gjithashtu, jep shembuj suksesi mbi avokimin e ESGJ për t'ju inspiruar – disa nga këto shembuj janë ide mjaft të thjeshta si shkrimi i një letre drejtuar një mësuesi/mësueseje apo drejtori/drejtoreshe shkolle, dhe të tjerat përfshijnë një nivel më të lartë avokimi, që ka në target qeveritë dhe nxitjen e tyre për ndryshimin e politikave edukuese.

Qëllimi i kësaj guide është inkurajimi i të rinjve për të mbrojtur të drejtat e tyre të shëndetit seksual dhe riprodhues, dhe mbështetja e të rinjve në procesin avokues për përmirësimin e ESGJ. Edhe pse është fokusuar më së shumti te të rinjtë, të rinjtë udhëheqës dhe tek organizatat, që u shërbejnë të rinjve, ne shpresojmë që ky udhëzues të jetë, gjithashtu, i vlefshëm edhe tek organizata të tjera, vullnetarë dhe aktivistë, të cilët duan të fillojnë ose fuqizojnë më tej avokimin për përmirësimin e edukimit seksual në të gjithë botën.

## ESGJ: BAZAT

*Përpara se të shtjellohemi më tej – le të qartësohemi se çfarë është edukimi seksual gjithëpërfshirës (ESGJ).*

**Edukimi Seksual Gjithëpërfshirës**, ose ESGJ është një term ndërkombëtar i përdorur për përshkrimin e edukimit seksual. Ndonjëherë termi edukim seksual nuk e pasqyron qartë se janë edhe një sërë çështjesh të cilat duhet të mbulohen. ESGJ nuk mbulon vetëm seksin: ESGJ duhet të mbulojë një gamë të gjerë temash si imazhi i trupit dhe vetëvlerësimi, rolet gjinore dhe shprehja gjinore, HIV-in dhe infeksione të tjera të transmetueshme seksualisht (SST), zgjedhjen e shtatzënisë, pëlqimin dhe kështu me radhë. Edukimi i mirë seksual e shikon seksualitetin si një pjesë të rëndësishme të zhvillimit njerëzor, dhe pajis të rinjtë me aftësitë, sjelljet dhe vlerat për të cilat kanë nevojë për të shijuar seksualitetin dhe identitetin e tyre, sidhe për të ndërmarrë vendime të informuara mbi seksualitetin dhe lidhjet e tyre.

**“Të rinjtë rreth botës kanë nevojë për edukim seksual gjithëpërfshirës, të përshtatshëm me moshën e tyre për të zhvilluar vetëbesimin dhe fituar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të bërë zgjedhje të ndërgjegjshme, të shëndetshme dhe të respektueshme mbi marrëdhëniet dhe seksualitetin e tyre.”**

**UNESCO<sup>1</sup>**

Ky dokument i referohet “të rinjve”, por është e rëndësishme të nënvizojmë se kjo mund të nënkuptojë gjëra të ndryshe te njerëz dhe organizata të ndryshme. Kombet e bashkuara përkufizojnë si të rinj moshën 15-24 vjeç. Në këtë dokument, kur ne përdorim termin “të rinj” nënkuptojmë fëmijët dhe të gjithë individët deri në moshën 24 vjeç<sup>2</sup>, duke qenë se të gjithë ne duhet të mësojmë rreth çështjeve të gjinisë, seksualitetit dhe lidhjeve nga një moshë shumë e re. Në të vërtetë ne vazhdojmë duke mësuar rreth këtyre temave gjatë gjithë moshës madhore.

# Çfarë lloj edukimi marrin të rinjtë mbi seksualitetin, gjininë dhe lidhjet?

Të rinjtë rreth botës kanë përvoja të ndryshme mbi edukimin seksual. Shumë prej tyre thonë se nuk kanë marë mjaftueshëm informacion mbi seksin dhe seksualitetin, se edukimi i është ofruar shumë vonë, ose edukimi i ofruar nuk ka pasur lidhje me përvojën e tyre personale. Ndonjëherë edukimi është shumë biologjik, duke u fokusuar vetëm në shkencën mbi seksin, SST dhe shtatzëninë, dhe nuk fokusohen te pëlqimi, lidhjet, dhuna me bazë gjinore, etj. Shpeshherë edukimi seksual ofrohet nga mësuesit, të cilët nuk janë trajnuar siç duhet, dhe që mund të mos jenë të gatshëm të flasin për tema më të diskutueshme ose të vështira. Atje, ku qeveritë premtojnë në ofrimin e edukimit seksual te të rinjtë, jo gjithmonë e ofrojnë në mënyrë të barabartë te të gjithë të rinjtë, sidomos përjashtohen ata që nuk janë në shkollë.



*“Unë nuk dija asgjë rreth seksit, nga shkolla dhe mësuesit – shoqëria dhe interneti ishin burimet e mia të vetme dhe më ofruan informacion të pasaktë.”*

**Waseem**



*“Kur isha e vogël mbaj mend mamanë që përpiqej të më frikësonte për të mos bërë seks, duke më thënë se është i dhimbshëm, ajo më thoshte se do të lëndohesha dhe do të kisha gjakderdhje dhe nuk do të isha në gjendje të ecja për një javë.”*

**Helena**



*“Askush nuk më tha që gjinia nuk përkufizon orientimin tënd seksual dhe nuk më treguan të gjithë llojet e gjinisë vetëm se njërezit janë mashkull/femër. Në shkolla na është thënë se homoseksualiteti nuk është normal dhe diskriminimi ishte aq i lartë saqë nëse ishe homoseksual përjashtoheshe nga shkolla.”*

**Molly**



*“Në fillim kur zbulova ëndrrat e lagura isha 12 vjeç dhe i frikësuar. Kisha turp të flisja me prinderit dhe vetëm pas dy vitesh në një orë biologjie në shkollë kuptova pse trupi im po ndryshonte.”*

**Davron**



*“Kur isha në klasë të gjashtë një mësues i ri filloi të na japë mësim në shkollë dhe ai na foli për përdorimin e prezervativëve – më parë unë nuk e dija se çfarë ishte prezervativi.”*



*“Prindërit e mi më frikësuan kur isha fëmijë. Ata më thanë se në momentin që do të kryej marrëdhënie seksuale, nuk do mundem të shkoj më në parajsë.”*

**Dennis**

Megjithatë, lajmi i mirë është se njerëzit në të gjithë botën po luftojnë për përmirësimin e edukimit seksual dhe në sigurimin që qeveritë të respektojnë marrëveshjet e tyre për shëndetin dhe edukimin e të rinjve. Të rinjtë janë ata të cilët përfitojnë në mënyrë direkte nga edukimi seksual gjithëpërfshirës cilësor, dhe janë ata të cilët ndikohen negativisht, kur nuk ofrohet informacion ose, kur nuk është i mjaftueshëm në përgatitjen e tyre mbi përvojat që mund të kenë ose vendimet që mund të ndërmarrin në jetën e tyre. Të rinjtë që janë në shkolla ose që kanë përfunduar së fundmi shkollën, kanë një nivel të mirë në të kuptuarin se çfarë është (ose s'është) edukimi seksual ofruar në shkolla, dhe shpeshherë kanë ide mjaft të mira në përmirësimin e mëtejshëm të situatës. Dhe pse në të gjithë botën ka mjaft organizata të cilat luftojnë për ESGJ (ne jemi lidhur me shumë prej tyre në këtë dokument) mendojmë se është domosdoshmëri që vetë të rinjtë të njihen si aktorë kyç dhe agjentë ndryshimi, dhe se zëri dhe opinionet e tyre duhet patjetër të dëgjohen.

Në kemi fakte që tregojnë se kur ESGJ bëhet siç duhet, ai është mjaft efektiv<sup>3</sup>. Mund t'i ndihmojë të rinjtë në shmangien e shtatzënieve të paqëllimshme, dhe infeksioneve seksualisht të transmetueshme, dhe, gjithashtu, në rritjen e njohurive dhe vetvlerësimit të tyre. Marrëveshjet e të drejtave njerëzore ndërkombëtare mbështesin të drejtat e të rinjve për një informacion të saktë mbi shëndetin e tyre - por edukimi seksual vazhdon të jetë një temë e diskutueshme në shumë vende, prandaj duhet të sigurohemi që ne si të rinj të jemi në gjendje të bëjmë argumente të qartë dhe bindëse përse çdo i ri meriton ESGJ me cilësi të lartë, pavarësisht se kush është apo ku jeton.





# Çfarë është një ESGJ “i mire”?

**“Thjesht duke thënë përse ESGJ është i rëndësishëm nuk mjafton. Ne duhet t'i kushtojmë vëmendje ofruesëve të ESGJ, ku ofrohet, çfarë ofrohet, kur ofrohet dhe si ofrohet.”**

**IPPF<sup>4</sup>**



UNESCO, ose Organizata Edukuese, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara, është agjencia brenda Kombeve të Bashkuara që fokusohet në përmirësimin e arsimit për të gjithë njerëzit në mbarë botën. UNESCO ka prodhuar mjaft burime të dobishme mbi edukimin seksual. Në këto burime përfshihet edhe një film i shkurtër rreth 3 minuta në të cilin flitet mbi rëndësinë e ESGJ, të cilin mund ta shihni duke klikuar foton më lart<sup>5</sup>, dhe një Rishikim Global mbi ESGJ që shqyrton bazën e provave për ESGJ dhe ndikimin pozitiv në shëndet; shikon mbështetjen publike ndaj ESGJ në vende të ndryshme; dhe shqyrton sesi politika të ndryshme ndikojnë mbi ofrimin e ESGJ në praktikë.<sup>6</sup>

Në përgjithësi, në këtë rishikim u vërejt se ndërkohë që shumë vende kanë politika në mbështetje të ESGJ, në praktikë nuk po ofrohet në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të barabartë. Njerëzit nuk po marrin mjaftueshëm informacion mbi gjininë dhe të drejtat, dhunën seksuale dhe gjinore, ose sesi qëndrimet kulturore dhe fetare ndikojnë në sjellje. Temat prezantohen shumë vonë, dhe shpeshherë jepen nga edukatorë të cilët nuk kanë një trajnim specifik mbi seksualitetin, shëndetin seksual dhe riprodhues dhe të drejtat.

Duke përdorur rekomandimet e UNESCOs, dhe njohuritë tona mbi atë se çfarë funksionon, ky seksion tregon sesi ESGJ “ideal” duhet të jetë, për të krijuar një pamje të qartë të asaj çfarë duhet të synojmë. Edhe në shtetet ku qeveria ofron ESGJ, ka në përgjithësi mënyra me të cilat mund të përmirësohet – për shembull arritja e të rinjve të cilët nuk janë në shkollë, ose mbulimi i një game më të gjerë çështjesh.



## GJITHËPËRFSHIRËS

Ndonjëherë njerëzit thonë "holistik" – por kjo në thelb do të thotë që të rinjtë duhet të mësojnë për një gamë të gjerë temash, jo vetëm një informacion, i cili bazohet mbi anatominë dhe biologjinë. Në këtë manual ne japim shembuj të standardeve ose udhëzimeve

që mund të përdoren për të kontrolluar temat dhe çështjet, të cilat duhet të mbulohen, për shembull Udhëzimi Teknik Ndërkombëtar i UNESCO mbi Edukimin Seksual.<sup>7</sup>



## BAZUAR TEK TË DREJTAT

Megjithëse ESGJ mund t'i ndihmojë të rinjtë për të qenë më të shëndetshëm, dhe mund të reduktojë normat e HIV/AIDS, SST-ve dhe shtatzënive të paqëllimshme, duhet të mësohet në një mënyrë që pranon të drejtat e të rinjve. Nuk ka një marrëveshje globale mbi

të drejtën ndaj ESGJ, por Kombet e Bashkuara kanë deklaruar se të gjithë njerëzit kanë të drejta ndaj një "edukimi cilësor dhe të barabartë" që përfshin të drejtat njerëzore dhe barazinë gjinore. ESGJ duhet të njohë faktin se të rinjtë kanë të drejtën e informimit dhe të edukimit mbi shëndetin dhe mirëqenien e tyre, si dhe të drejtën për të marë vendime të informuara mbi gjërat që ndikojnë në jetën e tyre. Për më shumë informacion rreth të drejtave seksuale për të rinjtë, shikoni udhëzuesin e IPPF për të rinjtë, "Exclaim!"<sup>8</sup>.



## PËR TË GJITHË MOSHAT

ESGJ është veçanërisht i rëndësishëm për moshat 10-12 vjeç duke qenë se kjo është mosha kur ndodhin ndryshimet trupore dhe fillojnë të kalojnë në adoleshencën e mëvonshme. Gjithsesi, edhe fëmijë më të vegjël kërkojnë informacion mbi trupin dhe të drejtat e

tyre, dhe idealja është që ESGJ të fillojë në shkollën fillore. Udhëzimi Teknik Ndërkombëtar i UNESCO-s mbi Edukimin Seksual jep disa ide mbi temat, që janë të përshtatshme për fëmijët nga mosha pesë deri në tetë vjeç. Këto përfshijnë gjëra të tilla si ndryshimet mes djemve dhe vajzave dhe sesi trupi ndryshon gjatë pubertetit, si dhe tema si: marrëdhëniet familjare, dashuria dhe martesja, privatësia dhe siguria, abuzimi seksual dhe kontrolli mbi trupin tonë, gjithashtu dhe respekti mbi diversitetin.

**"Fillimi i edukimit seksual në shkollën fillore u lejon fëmijëve të identifikojnë dhe raportojnë sjelljet e papërshtatshme (përfshirë abuzimin e fëmijëve) dhe zhvillon qëndrime të shëndosha mbi trupin dhe marrëdhëniet e tyre."**

**UNESCO<sup>9</sup>**



## TRANSFORMIMI GJINOR

Edukimi cilësor duhet të sfidojë idetë e dëmshme rreth meshkujve dhe femrave dhe duhet të përpiqet për barazinë gjinore. Kjo është ajo çfarë do të thotë transformim gjinor: transformimi i pikëpamjeve normale shoqërore dhe nxitja e marrëdhënieve të barabarta ndërmjet njerëzve.

ESGJ mund të promovojë më shumë qëndrime të barabarta gjinore midis të rinjve, duke përfshirë adresimin e qëndrimeve kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave, dhe promovimin e përfshirjes.<sup>10</sup>



## BRENDA DHE JASHTË SHKOLLËS

Edhe pse ekspertë të tillë si UNESCO bien dakord se është e rëndësishme që ESGJ të jetë pjesë e kurikulave të shkollës, janë rreth 263 milion fëmijë dhe të rinj që nuk janë në shkollë, kështu që ne duhet të gjejmë edhe mënyra për të ofruar ESGJ në mjedise të tjera, të tilla si

klubet e të rinjve dhe qendrat komunitare, që të përfshijmë sa më shumë të rinj që është e mundur.<sup>11</sup>



## PJESËMARRJA

Ju mund ta keni dëgjuar shprehjen “asgjë për ne pa ne” dhe kjo duhet të aplikohet, gjithashtu, edhe në edukimin seksual. Të rinjtë e dinë më së miri se për çfarë kanë nevojë dhe duhet të përfshihen në procesin e planifikimit dhe të vlerësimit të programeve edukuese për t'i siguruar

për rëndësinë që kanë atonë jetën e tyre. ESGJ duhet të mbulojë tema të tilla që të rinjtë të mendojnë se do t'i ndihmojnë për t'u përgatitur për situata reale siç është të mësuarit rreth pubertetit, pornografisë, të biesh në dashuri dhe tematë tjera të lidhura me këto çështje.



## PËRFSHIRJA

“Të rinjtë” nuk janë të gjithë njësoj dhe edukimi seksual duhet të jetë i përshtatshëm për nevoja dhe prejardhje të ndryshme. Veçanërisht brenda kontekstit të edukimit seksual, të rinjtë përfaqësojnë një diversitet të lartë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, dhe kjo

duhet të reflektohet në ESGJ, për shembull: duke mos supozuar se të gjithë çiftet janë një burrë dhe një grua, të përdorin fjalë si “partner” në vend të “e dashur” ose “i dashur” dhe duke mos supozuar asgjë mbi preferencat apo aktivitetin seksual të asnjërit.

**“Më shumë se 4/5 (85%) të të rinjëve gej, lezbike dhe biseksualë në Kombet e Bashkuara nuk u është mësuar në shkolla rreth aspekteve biologjike dhe fizike të marrëdhënieve ndërmjet të njëjtit seks.”**

**STONEWALL<sup>12</sup>**



## SAKTË

Ka shumë mite rreth seksit – dhe shumë prindër/kujdestarë mund të mos dinë mjaftueshëm rreth seksualitetit për t'i korrigjuar ato, ose mund të ndihen të sikletosur apo nuk dëshirojnë të flasin me fëmijët rreth këtyre çështjeve. ESGJ duhet të bazohet mbi kërkime dhe prova shkencore për të siguruar se të rinjtë kanë informacionin e saktë, që u duhet për të bërë zgjedhje të informuara.



## PROFESIONALE

Një nga problemet që shpesh njihet nga ESGJ është se në shumë raste njohuritë nuk ofrohet nga mësues, që janë trajnuar posaçërisht mbi ESGJ dhe mund të mos jenë në gjendje të flasin me besim rreth çështjeve që kanë të bëjnë me gjininë, seksualitetin dhe lidhjet. Edukuesit e ESGJ duhet të marrin trajnime me cilësi të lartë, në mënyrë të rregull dhe të jenë në gjendje të angazhojnë të rinjtë me një sërë aftësish dhe identitetesh.



## KONTEKSTI

Ka standarde ndërkombëtare dhe rajonale për programe të mira mbi ESGJ, por është e rëndësishme që programet të përshtaten me kontekstin vendor dhe t'i kushtojnë vëmendje temave të veçanta që ndikojnë të rinjtë në atë zonë, si për shembull martesat e hershme ose gjymtimi gjeneral femëror. Të dhënat dhe informacioni lokal mund të ndihmojnë në një kuptueshmëri më të mirë se çfarë janë nevojat specifike të të rinjve.



## LIDHUR ME SHËRBIMET

Të rinjtë nuk kanë nevojë vetëm për informacione dhe edukim mbi shëndetin e tyre seksual dhe riprodhues, por, gjithashtu, kanë nevojë të kenë akses ndaj shërbimeve që ofrojnë kujdes dhe mbështetje. ESGJ duhet të sigurojë lidhje me shërbimet vendore që mund të mbështesin të rinjtë dhe t'u bëjë atyre të ditur të drejtat e tyre për të qasur shërbimet.



## FUQIZIM

Edukimi nuk duhet të jete leksion vetëm me një drejtim – ESGJ duhet t'u japë të rinjve mundësinë të marrin njohuri por edhe të mendojnë në mënyrë kritike dhe të fuqizohen për të ndërmarrë zgjedhje të shëndetshme dhe t'i trajtojnë të tjerët me respekt. ESGJ duhet të jetë “i bazuar në aftësi”, dhe t'i ofrojë të rinjve aftësim për jetën si vetëndërgjegjësim, vlerësim dhe komunikim. Kjo qasje fuqizon të rinjtë për të ndërmarrë vendime të vetëdijshme dhe të informuara mbi lidhjet dhe seksualitetin, dhe të marrin kontrollin e jetës së tyre.





## NJË HAPËSIRË E SIGURT

Institucionet dhe organizatat edukuese duhet të kenë politika të mbrojtjes së fëmijëve për të drejtat e tyre për privatësi dhe konfidencialitet, por dhe të mund t'i mbështesin ata, kur janë në rrezik. Shkollat dhe vende të tjera në të cilat mësohet ESGJ duhet të

jenë jo diskriminuese dhe të kenë politika të forta kundër bullizmit, ngacmimeve seksuale, diskriminimit dhe dhunës, në mënyrë që fëmijët të jenë të sigurt, të shëndetshëm dhe të aftë për të mësuar.



## SEKSI POZITIV

Është treguar se programet edukuese që promovojnë abstinencë (të mos bërit seks para martesë) në të vërtetë nuk i ndalojnë të rinjtë të bëjnë seks, dhe mund të ndikojë në pëlqyeshmërinë e tyre për të përdorur prezervativ ose forma të tjera kontracepsioni kur bëjnë

seks.<sup>13</sup> Sigurisht, të presësh për të bërë seks mund të jetë zgjedhja e duhur për disa të rinj, por nuk do të jetë zgjedhja e duhur për të gjithë. Kjo lidhet ngushtë me qasjen e bazuar mbi të drejta të cilën e kemi diskutuar më parë në këtë seksion.

**“Një mjedis edukues i sigurt, i lirë nga bullizmi, diskriminimi, ngacmimet, dhe dhuna, është thelbësor për të mësuarin efektiv në çdo lëndë. Vajzat sidomos janë, gjithashtu, të pambrojtura ndaj përparimeve seksuale nga të rriturit që hasin rrugës për në shkollë ose në shkollë. Të rinjtë, veçanërisht djemtë, që nuk përputhen me rolet konvencionale gjinore, ose që perceptohen si homoseksualë, mund të jenë subjekt i ngacmimeve dhe dhunës, si dhe studentët me aftësi ndryshe ose që perceptohen si mbartës të HIV-it mund të jenë të stigmatizuar. Kurikulat, që shmangin përmendjen e këtyre temave, dëmtojnë aftësinë e nxënësve për të mbrojtur veten dhe kanë një efekt heshtjeje në aftësinë e tyre për të kërkuar ndihmë.”**

**UNESCO<sup>14</sup>**

# AVOKACI 101

Avokasia nënkupton gjëra të ndryshme për njerëz të ndryshëm, por në mënyrë bazike nënkupton identifikimin dhe thirrjen për ndryshime në ligje, politika, praktika dhe struktura me synim përmirësimin e jetës së njerëzve. Ajo i referohet mënyrave të ndryshme me anë të të cilave ne mund të krijojmë mbështetje politike, financiare dhe publike për të influencuar udhëheqësit dhe vendimmarrësit për adresimin e shkaqeve kryesore të problemeve dhe në gjenerimin e zgjidhjeve të qëndrueshme afatgjata.<sup>15</sup> Për shembull, ne mund të avokojmë për rritjen e mbështetjes mbi një kauzë, për të influencuar vendimmarrësit për krijimin e një ambienti, që i mundëson të rinjve të vetushtrajnë të drejtat e tyre, ose të ndryshojnë ligjin ose legjislacionin. Ndryshimi mund të ndodhë në disa nivele, të tilla si në nivel vendor (për shembull me qeverinë vendore, policinë, liderat fetarë, sistemin shkollor), në nivel kombëtar (për shembull me qeverinë e vendit, ministrat), ose në nivel ndërkombëtar (për shembull me agjencitë e UN ose Bankën Botërore). Ndryshimi zakonisht ndodh në tri faza:

## **KOKA** njohuritë

*Fillimisht, audienca juaj e targetuar ka nevojë të ketë një informacion të saktë me qëllim që të kuptojë ndryshimet për të cilat ju po avokoni dhe pse po e propozoni këtë gjë.*

## **ZEMRA** sjellja

*Edhe nëse audienca juaj e targetuar ka të gjithë informacionin teknik, ajo mund të ketë nevojë të bindet mbi përfitimet dhe vlerën e propozimit tuaj, ta dijë në zemrën e saj se ajo çfarë ju po propozoni është gjëja e duhur për t'u bërë.*

## **DUART** praktika

*Pasi të keni aleatët për kauzën tuaj, ju akoma mund t'ju duhet t'i mbështesni ata ta përkthejnë ndryshimin e propozuar në veprim. Kjo mund të përfshijë punën me individë dhe organizata të tjera për të maksimizuar efektivitetin tuaj dhe monitoruar sesi ky ndryshim po implementohet për t'u siguruar që strategjitë tuaja po punojnë në mënyrë efektive drejt ndryshimit.*



# TË OFROSH EVIDENCA PËR ESGJ

Siç dhe mund ta dini, ESGJ mbetet një lëndë e diskutueshme në shumë shtete. Ajo edhe atje, ku është aprovuar nga qeveria dhe mësohet në shkolla, mund të ketë ende tema të caktuara të ndjeshme të cilat nuk u mësohen të rinjve. Madje mund të ketë edhe grupe të cilat bëjnë fushata *kundër* ESGJ duke u përpjekur të reduktojnë numrin e të rinjve të cilët marrin këto mësim. Përpara se të nisësh ndonjë veprim duke u përpjekur për të përmirësuar edukimin seksual në vendin ku jeton, ti duhet të sigurohesh që ke një kuptueshmëri të mirë se si dhe pse ESGJ i ndihmon të rinjtë të qëndrojnë të shëndetshëm, dhe si të adresojnë disa nga argumentet e njerëzve që janë kundër ESGJ. Ne kemi dhënë një panoramë vërtet të shkurtër këtu, por për informata më të hollësishme mund të shikoni në seksionin "burimet".

- ▶ ESGJ ka një ndikim pozitiv në shëndetin seksual dhe riprodhues, dhe mund të kontribuojë në **reduktimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme (përfshirë HIV) dhe shtatzënitë e paqëllimshme.**<sup>16</sup>
- ▶ Edukimi seksual nuk i inkurajon të rinjtë të bëjnë seks herët, por ka një impakt pozitiv në sjelljet seksualisht të shëndetshme dhe **mund të vonojë moshën e të bërit seks për herë të parë dhe të nxisë përdorimin e prezervativëve.**<sup>17</sup>
- ▶ ESGJ fuqizon të rinjtë të reflektojnë në mënyrë kritike mbi ambientin dhe sjelljet e tyre, dhe **promovon barazinë gjinore dhe normat e barabarta shoqërore**, të cilat janë faktorë të rëndësishëm kontribues në përmirësimin e rezultateve të shëndetit përfshirë dhe normat e e infeksionit të HIV.<sup>18</sup>
- ▶ ESGJ mund të **përmirësojë njohuritë dhe vetë-vlerësimin**, duke ndryshuar qëndrimet, normat gjinore dhe sociale, dhe duke ndërtuar vetefikasitetin.
- ▶ Integrimi i përmbajtjes së gjinisë dhe të drejtave mund ta bëjë edukimin seksual edhe më efektiv: një studim zbuloi se programet që trajtonin marrëdhëniet gjinore ose të pushtetit ishin të lidhura me një **rënie të konsiderueshme në shtatzëni, lindjen e fëmijëve ose SST.**<sup>19</sup>
- ▶ Ndikimi i ESGJ rritet kur ofrohet së bashku me përpjekjet për zgjerimin e qasjes së një game të gjerë **shërbimesh dhe produktesh cilësorë (si kontraceptivët) që janë miqësorë për të rinjtë.**<sup>20</sup>

# Pyetjet më të shpeshta për ESGJ

*Ky seksion trajton disa pyetje mjaft të shpeshta për ESGJ dhe disa përgjigje.*



## Çfarë është “edukimi bashkëmoshatar”, dhe a është efektiv?

“Edukimi bashkëmoshatar” është kur njerëzit mësojnë bashkëmoshtatarët e tyre mbi një temë të caktuar. Në këtë kontekst i referohet të rinjve të cilët mësojnë të rinj të tjerë mbi çështjet e lidhura me shëndetin seksual dhe riprodhues dhe mbështetet në idenë se të rinjtë janë më të hapur në ndryshimin e sjelljes së tyre nëse këshillohen apo rekomandohet nga bashkëmoshatarë që ata njohin dhe besojnë.<sup>21</sup> Provat tregojnë se ndërkohë që edukimi bashkëmoshatar është një mjet i mirë për shpërndarjen e informacionit, dhe shumë i dobishëm për vetë edukatorët bashkëmoshatar, programi i edukatorëve bashkëmoshatar nëse nuk kombinohet me nisma të tjera, ka efekte të limituara në përmirësimin e rezultateve të shëndetit. Edukimi bashkëmoshatar është i dobishëm për referimin e të rinjve te shërbimet shëndetësore. Gjithashtu, edukimi bashkëmoshatar mbi ESGJ është veçanërisht i dobishëm për arritjen e të rinjve në grupet e marxhinalizuara që mund të stigmatizohen nga edukimi ose shërbimet shëndetësore “tradicionale” dhe janë më të lirshëm për t'u përfshirë me dikë që i kupton çështjet e tyre. Kjo përfshin të rinjtë që janë punonjës seksi, përdorues droge, të rinjtë që jetojnë me HIV, etj.<sup>22</sup>



## A mundet në fakt ESGJ të ndryshojë pikëpamjet dhe sjelljet e rënjosura thellë?

Provat tregojnë se ofrimi i programeve të edukimit seksual mund të ketë një impakt real në sjelljet e të rinjve, si dhe në pikëpamjet dhe vlerat e komunitetit. Për shembull, një raport nga Plan UK dhe Social Development Direct tregoi se ESGJ mund të promovojë një ndryshim pozitiv në normat sociale rreth dhunës me bazë gjinore, dhe mund të targetojë idetë e dëmshme të maskilizmit dhe stereotipeve gjinore në shkolla dhe në komunitetin e gjerë.<sup>23</sup> Një rishikim i 22 programeve të edukimit seksual gjeti se 80% e programeve që adresonin marrëdhëniet gjinore ose të fuqisë ishin të lidhura më rënie të rëndësishme të shtatzënive, lindjeve dhe SST.<sup>24</sup>







### **Çfarë është “zhvillimi i kapaciteteve”?**

Zhvillimi i kapaciteteve, i quajtur, gjithashtu, edhe shfaqje kapacitetesh, i referohet mënyrës sesi të rinjtë matorohen dhe rriten, dhe sesi aftësia për të marrë përgjegjësi për veprimet e tyre rritet me rritjen e moshës. Kjo ndodh me një shpejtësi të ndryshme për të gjithë të rinjtë. ESGJ mund të ndihmojë të rinjtë të zhvillojnë kapacitetet e tyre dhe të marrin vetë vendime për shëndetin dhe kujdesin shëndetësor të tyre.<sup>25</sup>



### **Çfarë është seksi pozitiv?**

Seksi pozitiv interpretohet zakonisht si “i gjithë seksi është i mirë” – por në realitet seksi pozitiv është një sjellje që manifeston seksualitetin si një pjesë të jetës që mund të rrisë lumturinë, të sjellë energji dhe festime. Qasjet pozitive të seksit synojnë të arrijnë përvojë ideale, në vend që të punojnë vetëm për të ndaluar përvojat negative. Qasjet pozitive të seksit pranojnë dhe trajtojnë rreziqet e ndryshme që lidhen me seksualitetin, pa përforcuar frikën, turpin apo tabutë që rrethojnë seksualitetin e të rinjve.<sup>26</sup>



### **Pse duhet të flasim për gjininë në ESGJ?**

Një rishikim i programeve të ESGJ nga UNESCO gjeti se ato programe të cilat adresonin marrëdhëniet e gjinisë ose pushtetit ishin pesë herë më premtues për të qenë efektivë se programet që nuk i adresonin këto çështje. 80% e programeve të cilat diskutonin gjininë ose pushtetin ishin të lidhur me një ulje të rëndësishme të SST dhe shtatzënive të padëshirueshme.<sup>27</sup> Ky kërkim sugjeroi se të rinjtë që kanë qëndrime të barabarta ndaj roleve gjinore në një marrëdhënie kanë më shumë gjasa të vonojnë debutimin seksual, të përdorin prezervativë, dhe të përdorin kontracepsion, kur bëjnë seks, i cili mund t'i çojë në shtatzëni të paqëllimshme. Është, gjithashtu, e rëndësishme të diskutohet gjinia, sepse gjinia është një spektër identiteti dhe është e rëndësishme të kuptohet se disa individë nuk identifikohen si “mashkull” ose “femër”. Qeniet njerëzore janë mrekullisht të ndryshme dhe ne duhet të respektojmë të gjitha identitetet tona.

# MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

Përpara se të avokojmë për një ESGJ më të mirë, është e rëndësishme të dijmë jo vetëm mbi faktet që e mbështesin atë por, gjithashtu, edhe mbi strukturat ndërkombëtare që mbështesin ofrimin e edukimit seksual të rinjtë. Mbi të gjitha, të rinjtë (mosha 15-24 vjeç) përbëjnë një të katërtën e popullsisë së botës – arritja e të drejtave dhe mirëqenies së tyre duhet të jetë në qendër të çdo lëvizjeje për të rritur të drejtat njerëzore dhe mirëqenien. Rishikimi Global i ESGJ 2016 nga UNESCO tregon se shumica e vendeve përkrahin konceptin e ESGJ dhe po kërkojnë të fuqizojnë implementimin e tij.<sup>28</sup> Kjo rritje e angazhimit politik botëror ndaj ESGJ është diçka fantastike, dhe është një pikë e mirë fillimi ndaj avokacisë për të siguruar se të gjithë të rinjtë përfitojnë nga përmbajtja dhe ofrimi i ESGJ.

## Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Një vend i dobishëm për të filluar është “Agjenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm”. Ky është një grup i 17 objektivave të pranuar ndërkombëtarisht (“Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm” ose SDG) ku të 193 shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara janë zotuar se këto objektiva do të udhëheqin politikat dhe fondet deri në vitin 2030. Brenda “Agjenda 2030” janë qëllimet për t'i dhënë fund të gjitha formave të varfërisë, për të luftuar pabarazitë dhe për të ndaluar ndryshimet klimaterike, duke siguruar që askush të mos mbetet pas.

Gjatë avokimit mbi ESGJ-në ju mund t'i përdorni SDG-të për të fuqizuar argumentet se të gjithë të rinjtë duhet të marrin edukim mbi gjininë, seksualitetin dhe të drejtat. Ekzistojnë disa objektiva kyçe që mund t'i theksoni gjatë avokimit tuaj. Për shembull, Qëllimi 3 përpiket të sigurojë jetë të shëndetshme dhe mirëqenie për të gjithë. Sipas këtij qëllimi, objektivi 3.7 angazhon vendet anëtare të sigurojnë “qasje universale ndaj shërbimeve të kujdesit shëndetësor seksual dhe riprodhues, përfshirë planifikimin familjar, informimin dhe edukimin, si integrimin e shëndetit riprodhues në strategjitë dhe programet kombëtare”.



Nën qëllimin 4, që është për edukimin gjithëpërfshirës dhe cilësor, në objektivin 4.7 thuhet se në vitin 2030 të gjithë nxënësit duhet të “marrin njohuritë, aftësitë e nevojshme për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm, përfshirë, ndër të tjera, edukimin për një zhvillim të qëndrueshëm dhe jetesë të qëndrueshme, të drejtat njerëzore, barazinë gjinore, promovimin e një kulture paqeje dhe jo dhune, qytetarinë globale dhe vlerësimin e diversitetit kulturor dhe kontributin e kulturës në zhvillimin e qëndrueshëm.” Edhe pse ESGJ nuk përmendet në mënyrë direkte, ka lidhje të qarta me njohuritë dhe aftësitë e të rinjve mbi çështjet e të drejtave njerëzore, barazinë gjinore dhe qytetarinë. Qëllimi 5 kërkon të sigurojë barazinë gjinore dhe të fuqizojë gratë dhe vajzat. Nën këtë qëllim, Objektivi 5.6 i bën qeveritë përgjegjëse për sigurimin e “qasjes universale ndaj shëndetit seksual dhe riprodhues dhe të drejtave riprodhuese”. Ne kemi dalë në përfundimin se ESGJ përmbush të drejtat seksuale të të rinjve, dhe se një ESGJ i mirë ndihmon në krijimin e ndryshimeve pozitive ndaj sjelljeve rreth gjinisë.

## Angazhimi i Afrikës Lindore dhe Jugore

Nëse ti jeton në Angola, Botsëana, Burundi, DRC, Ethiopia, Kenya, Lesotho, Madagascar, Malaëi, Mauritius, Mozambique, Namibia, Rëanda, Seychelles, South Africa, South Sudan, Sëaziland, Tanzania, Uganda, Zambia or Zimbabwe, qeveria jote ka nënshkruar “Angazhimi i Afrikës Lindore dhe Jugore” (Angazhimi i ALJ) në dhjetor të vitit 2013. Angazhimi i ALJ detyron qeveritë të mbështesin edukimin seksual dhe shërbimet ndaj shëndetit seksual dhe riprodhues për të rinjtë, dhe sugjeron fillimin e ESGJ gjatë shkollës fillore të përshtatshëm sipas moshës, para se të rinjtë/fëmijët të jenë seksualisht aktivë. Nëse ti je nga Afrika Lindore ose Jugore, shiko Young People Today, një partneritet ndërmjet Kombeve të Bashkuara dhe Ministrisë së Shëndetësisë nga rajoni i ALJ që fokusohet te të drejtat e të rinjve ndaj ESGJ.

**“Përdorimi i standardeve ndërkombëtare të miratuara, siguron që ESGJ është i përshtatshëm nga pikëpamja e moshës, gjinisë dhe kulturës, i bazuar në të drejta dhe përfshin elemente thelbësorë si njohuritë, aftësitë dhe vlerat si një përgatitje për moshën e rritur: vendimmarrje mbi seksualitetin, marrëdhëniet, barazinë gjinore, shëndetin seksual dhe riprodhues, dhe qytetarinë.”**

**ANGAZHIMI I AFRIKËS LINDORE DHE JUGORE<sup>29</sup>**

## **Konsensusi i Montevideo**

---

“Konsensusi i Montevideo” mbi popullsinë dhe zhvillimin është një marrëveshje në Amerikën Latine dhe Karaibe e cila mbulon shëndetin seksual dhe riprodhues, të drejtat e të rinjve, dhe barazinë gjinore.<sup>30</sup> Marrëveshja nënvizon të drejtat e të gjithë individëve për të “përkrahur të drejtën për një jetë seksuale të sigurt dhe të plotë, si dhe të drejtën për të marrë vendime në mënyrë të lirë, të informuar, vullnetare dhe të përgjegjshme mbi seksualitetin e tyre, orientimin seksual dhe identitetin gjinor, pa forcë, diskriminim ose dhunë”. Në mënyrë specifike kërkon implementimin e ESGJ që në fëmijërinë e hershme, duke njohur zhvillimin e kapaciteteve të rinjtë, dhe promovon edukimin, që bazohet në të drejtat njerëzore dhe barazinë. Më e rëndësishme është se një që të rinjtë dhe adoleshentët janë “mbajtësit e të drejtave dhe palët e interesuara në zhvillim” – nëse ju po bëni avokim mbi ESGJ në këtë rajon, ju mund të përdorni Konsensusin e Montevideo për të treguar se këto marrëveshje janë bërë për të promovuar të drejtat seksuale dhe riprodhuese të një niveli të lartë të rinjtë.

## **Deklarata Politike e Nivelit të Lartë për HIV / AIDS**

---

“Deklarata Politike” është një tjetër dokument i adaptuar ndërkombëtar, i cili përmban objektiva dhe veprime specifike që duhet të arrihen nëse bota do t'i japë fund epidemisë së AIDS-it deri në vitin 2030.<sup>31</sup> Deklarata i bën thirrje qeverive që të mbrojnë qasjen në “informacione, edukim dhe shërbime të përshtatshme, me cilësi të lartë, të bazuar në fakte, pa stigmatizim dhe diskriminim, me respekt të plotë për të drejtat e privatësisë, konfidencialitetit dhe pëlqimin e informuar”. Gjithashtu, thekson nevojën për të rritur disponueshmërinë e “edukimit gjithëpërfshirës shkencor të saktë dhe të përshtatshëm për moshën, që lidhet me kontekstin kulturor, që u siguron vajzave dhe djemve adoleshentë, grave dhe burrave të rinj, brenda dhe jashtë shkollës, në përputhje me kapacitetet e tyre në zhvillim, informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues dhe parandalimin e HIV, barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, të drejtat e njeriut, zhvillimin fizik, psikologjik dhe pubertetin, si dhe fuqinë në marrëdhëniet midis grave dhe burrave”. Ky është një dokument kyç në përgjigjen globale ndaj HIV dhe AIDS dhe në mënyrë specifike përshkruan ESGJ si një mjet jetik për të promovuar të drejtat e të rinjve dhe zhvillimin e shëndetshëm.

# SI TË AVOKOHET PËR ESGJ

Në këtë sesion ne skicojmë disa hapa bazike që mund të ndihmojnë në formimin e një fushate. Shumica e shembujve fokusohen në avokimin vendor ose kombëtar, por ka, gjithashtu, burime të listuara për ata, të cilët janë të angazhuar në avokimin ndërkombëtar, siç është fushata në Kombet e Bashkuara. Mund të jetë më mirë të vazhdohet në nivel vendor, me qëllime të arritshme, dhe ta rrisni fushatën tuaj dhe kështu mund të ndërmerrni sfida më të mëdha me më shumë përvojë!

## Hapi i parë: Përcaktoni qëllimet tuaja

Çfarë doni të ndryshoni? Thjesht duke thënë se dëshironi që të ketë edukim seksual në shkollën apo vendin tuaj, nuk është mjaftueshëm specifike. Avokimi juaj do të jetë shumë më tepër efektiv nëse keni një qëllim dhe objektiva vërtet të qartë, kështuqë para se të nisni një fushatë për ndryshim, është e dobishme të mendoni rreth asaj se çfarë ju doni të arrini saktësisht. Kjo, gjithashtu, do të sigurojë që të gjithë ata që janë të përfshirë në fushatën tuaj avokuese, të japin mesazhe të qarta dhe të qëndrueshme. Mund të keni shumë gjëra që dëshironi të ndryshoni, por një fushatë do të ishte më efektive nëse është shumë e shënjestruar dhe e përshtatur. Ndonjëherë është një ide e mirë që të diskutoni me një grup miqsh për të gjitha çështjet që mund të mendoni, dhe pastaj t'i jepni përparësi vetëm një ose dy çështjeve që doni të përqëndroheni. Gjatë kohës që e bëni këtë, përpiquni të identifikoni shkaqet kryesore të secilës çështje – për shembull, ndoshta shkolla juaj nuk ofron ESGJ si shkak i kundërshtimit nga prindërit ose komuniteti fetar, si shkak i mungesës së parave, si shkak i mungesës së mësuesëve të trajnuar, ose thjesht sepse udhëheqësit e shkollës nuk janë në dijeni të rëndësisë apo përfitimeve të ESGJ. Shkaqet e çështjes suaj do të ndryshojnë mënyrën sesi do të avokoni për ndryshimin e situatës.

Kështu le të themi se ESGJ në shkollën tuaj nuk është mjaftueshëm gjithpërfshirës, dhe ju doni ta përmirësoni atë.

**QËLLIMET** tuaja ngrihen mbi këtë çështje, për ta bërë atë më specifike. Shton se kë do të synosh, çfarë do të ishte zgjidhja, dhe kur do të arrihet. Për shembull, qëllimi juaj mund të jetë që drejtori i shkollës të implementojë një program të ri ESGJ në shkollën tuaj brenda 18 muajve të ardhshëm.

**OBJEKTIVAT** tuaja e ndajnë këtë në hapa më konkretë, që duhet të ndërmerreni për të arritur qëllimin tuaj të përgjithshëm - mendoni për ta si hapat e një shkalle që çon në arritjen e qëllimit tuaj në shkollën më të lartë. Objektivat tuaja duhet të jenë të qarta dhe të fokusuara, dhe ju nuk duhet të keni më shumë se tre. Një objektiv mund të jetë mbajtja e një takimi me studentët dhe drejtorin brenda tre muajve të ardhshëm, për të ndarë shqetësimet tuaja në lidhje me kurikulën aktuale dhe të ofroni ide se si të mund ta ndryshoni atë dhe çfarë nevojitet për ta bërë këtë.

Ju duhet, gjithashtu, të nxirrni disa **INDIKATORË**. Këto janë gjëra të cilat do t'i masni për të parë nëse jeni apo jo në rrugën tuaj për arritjen e qëllimit avokues. Sa më shumë specifike të jenë këta indikatorë, aq më e lehtë do të jetë për t'i matur. Ato mund të jenë gjëra të tilla si: numri i mësuesve që mbështesin idenë e një kurikule të re; numri i prindërve që firmosin një letër ose peticion për përmirësimin e ESGJ, etj.

## OBJEKTIVAT SMART

Objektivat më të mirë janë ato SMART. Këto zbërthehen në:

- ▶ **Specifike (Specific)** – përqëndrohuni te kush / çfarë / kur dhe ku të asaj që dëshironi të arrini;
- ▶ **Të matshme (Measurable)** – ajo çfarë ju bëni duhet të jetë e matshme, e numërueshme dhe e vëzhgueshme;
- ▶ **E arritshme (Achievable)** – qëllimi juaj duhet të jetë realist dhe i arritshëm;
- ▶ **I përshtatshëm (Relevant)** – ndryshimi që synoni të bëni duhet të bazohet në një nevojë të identifikuar, në përshtatje me kontekstin tuaj;
- ▶ **Koha e lidhur (Time-bound)** – ju duhet të përfshini një kornizë kohe reale.

PACT ka prodhuar një mjet strategjik avokues, i cili kalon nëpërtë në detaje dhe ka shumë lista dhe template të dobishme që mund t'i përdorni për të zhvilluar strategjinë tuaj. Për më shumë detaje shihni pjesën "Burimet".



## Hapi dy: Mblidhni faktet tuaja

Çdo qëllim apo objektiv që do t'ju shërbejë për të prezantuar apo përmirësuar ESGJ do të jetë domosdoshmërisht i shoqëruar me fakte. Kjo nuk ka pse të jetë një kërkim akademik, faktet tuaja mund të merren edhe nga të folurit me individët e komunitetit tuaj. Faktet që ju keni nevojë mund të egzistojnë tashmë (për shembull, një raport, i cili tregon se vajzat po përjetojnë ngacmime seksuale në shkolla) por, gjithashtu, mund të vendosni t'i mblidhni vetë faktet. Kjo mund të jetë:

- ▶ Një studim online, i cili u kërkon të rinjve në vendin tuaj të raportojnë për edukimin seksual që kanë marrë në shkollë dhe cilat tema janë mbuluar;
- ▶ Fokus grupe me të rinjtë për atë që ata do të donin që ESGJ të përfshinte;
- ▶ Intervista me prindërit për atë që ata do të donin që fëmijët e tyre të mësonin gjatë ESGJ;
- ▶ Një pyetsor, i cili teston njohuritë e të rinjve mbi tema të caktuara ose vlerëson qëndrimet e tyre.

Ka dy lloje kryesore të fakteve:

**Faktet Sasiore**, të cilat mund të numërohen ose maten. Ato janë zakonisht numra, për shembull numri i personave që kanë mësuar për pëlqimin në ESGJ, ose numri i shkollave në zonën tuaj me një politike për ofrimin e ESGJ.

**Faktet Cilësore**, të cilat nuk mund të numërohen, por grumbullojnë përvoja ose sjellje nga njerëzit. Faktet cilësore përfshijnë gjëra si intervistat me të rinjtë rreth ESGJ që ata kanë marrë në shkollë dhe çfarë kanë menduar për të.

### BURIMET MBI TË DHËNAT DHE FAKTET

- ▶ Mjeti "Explore" nga Rutgers jep shumë informacione të vlefshme rreth mënyrës si të bëjmë kërkime dhe të mbledhim të dhëna, përfshirë udhëzime sesi të zhvillojmë intervista dhe fokus grupe.<sup>32</sup>
- ▶ Mjeti i vlerësimit "Sexuality Education Review and Assessment Tool (SERAT)" krijuar nga UNESCO mund të përdoret për të mbledhur të dhëna për programet bazë shkollore mbi ESGJ në shkollat fillore dhe 9-vjeçare.<sup>33</sup>
- ▶ Mjeti i vlerësimit "Inside and Out" i IPPF përshtat mjetin SERAT për përdorim në programet e ESGJ brenda dhe jashtë ambientit shkollor.<sup>34</sup>

## Hapi tre: Sigurimi i mbështetjes

Ju keni më shumë gjasa të keni sukses nëse fushata juaj bën shumë zhurmë, dhe kjo arrihet më së miri duke pasur shumë mbështetës. Është e rëndësishme të punosh për burimet se ku mund të fitosh përkrahje dhe të përpiqesh të bësh sa më shumë partneritete dhe aleanca sipas nevojës. Ju ndoshta do të duhet ta përshtasni informacionin, sipas grupeve të ndryshme, për ta bërë atë më të përshtatshëm dhe më të arritshëm.



### TË RINJTË

Nëse fushata juaj bazohet në një shkollë, gjimnaz apo universitet, ju mund të fitoni mbështetës duke mbajtur bisedime ose duke ngritur një tabelë informacioni në kampus me fletëpalosje, peticione ose fletë regjistrimi. Ju, gjithashtu, mund të dëshironi të

mendonin rreth përdorimit të medias sociale dhe email-it për të mbajtur vrullin dhe për të përhapur ndërgjegjësim për atë që po përpiqeni të arrini. Përpiquni të lidheni me grupet e studentëve dhe organizatat, që punojnë në arsim ose shëndetin e të rinjve për të përhapur mesazhin tuaj në rrjetet e tyre të të rinjve.



### PRINDËRIT DHE FAMILJET

Kur bëhet fjalë për ESGJ është shumë e rëndësishme të përpiqeni të fitoni mbështetjen e prindërve dhe kujdestarëve. Mesazhet ndaj prindërve mund të fokusohen rreth rezultateve pozitive të shëndetit dhe mirëqenies për fëmijët dhe të rinjtë. Konsultohuni

me anëtarë të komunitetit për gjetjen e mënyrave për të folur rreth ESGJ, të cilat janë të ndjeshme nga pikëpamja kulturore, dhe përdorni fakte dhe statistika për të risiguruar prindërit që ESGJ nuk është dëmtues. Ju mund të organizoni një takim publik me të rinjtë dhe të moshuarit për të diskutuar haptazi mbi ESGJ, dhe të përpiqeni të punoni së bashku mbi qëllimet e përbashkëta të tilla si rritja e shëndetit dhe sigurisë të të rinjtë.



### MËSUESIT OSE DREJTUESIT E SHKOLLËS

Duke ofruar programet e ESGJ, shkolla mbështet shëndetin e nxënësve dhe nxit arritjet e tyre akademike, duke i ndihmuar të rinjtë të shmangin shtatzënitë e paqëllimshme dhe çështje të tjera, të cilat mund të ndikojnë pjesëmarrjen në shkollë. Mësuesve

do t'u duhet të shohin fakte që mbështesin përfitimet edukuese të ESGJ, dhe që përshtaten me politikat e tyre ekzistuese. Përdorimi i informacionit nga organizata të respektuara si UNESCO, si dhe gjetja e seksioneve





përkatëse të politikave kombëtare dhe shkollore që mbështesin mirëqenien e të rinjve mund të ndihmojnë në rastin tuaj. Mësimdhënësit dhe guvernatorët, si dhe vetë të rinjtë mund t'i përgjigjen mirë letrave nga prindërit dhe profesionistët e shëndetësisë duke theksuar shqetësimet e tyre rreth ofrimit të CSEx.



## POLITIKANËT

Anëtarët e parlamentit e kanë detyrë t'u përgjigjen nevojave të njerëzve që jetojnë në një rajon (kërkesave të tyre të ligjshme). Nëse po përpiqeni të flisni me një politikan dhe vendimmarrës rreth ESGJ, është kritike të fokusoheni në mbështetjen publike për

çështjen tuaj ;për shembull, një peticion i firmosur nga shumë anëtarë të komunitetit tuaj, ose një fushatë për shkrimin e një letre për të treguar mbështetje të gjerë. Politikanët jo domosdoshmërisht do të kenë shumë njohuri rreth ESGJ dhe përfitimeve të tij, kështuqë sigurohuni të ndani fakte, dhe kjo mund të përfshijë edhe përvojë tuaj në shkollë dhe jasht saj. Ju duhet të hulumtoni pikëpamjet e tyre individuale apo partiake mbi çështjet që kanë të bëjnë me të rinjtë ose shëndetin seksual dhe riprodhues dhe të përpiqeni të lidheni me to . Për shembull, ndoshta ata kanë punuar më parë mbi të drejtat e grave të cilat mund t'i lidhni me gjininë në ESGJ.



## MEDIA

Marrja e gazetarëve individualë (madje edhe të famshëm) për të kuptuar dhe mbështetur çështjen tuaj mund të ndihmojë me të vërtetë për të rritur ndërgjegjësimin dhe për t'i vënë nën presionin publik politikanët dhe vendimmarrësit e tjerë për të bërë

ndryshime. Përveç nevojës për fakte, gazetarët mund të dëshirojnë edhe "raste studimore" individuale për të sjellë të gjallë historinë. Bisedoni me të rinjtë e tjerë në zonën tuaj ose grupin e të rinjve për të parë nëse ndonjëri prej tyre është i gatshëm të flasë për përvojat e tyre të ESGJ-së dhe çfarë dëshirojnë të shohin që të ndryshojë në të ardhmen.

**Mos harroni edhe kur keni të bëni me organizata dhe institucione, në të vërtetë ju keni të bëni me njerëzit që punojnë në to. Pra, qëllimi juaj nuk duhet të jetë shkolla juaj, por më tepër drejtori i shkollës suaj; jo vetëm mediat, por një gazetar individual. Ndryshimi i mendjeve mbase edhe vetëm i disa njerëzve për një çështje, mund të bëjë një ndryshim të madh.**

*Shikoni seksionin "Burimet" të këtij udhëzuesi, i cili ka akoma më shumë mjete avokuese të zhvilluara nga PACT, duke përfshirë Mjetin për Strategjinë e Avokimit, dhe udhëzon sesi të bëjmë avokim në mediat sociale dhe si të shkruajmë letra avokuese. Ka edhe disa dokumente të dobishëm për njerëzit e tjerë, që mund të dëshirojnë t'ju mbështesin, duke përfshirë prindërit, mësuesit dhe udhëheqësit e komunitetit.*

# Hapi katër: Ndërmerrni veprim!

---

Më poshtë po japim disa ide për veprime të mundshme që mund të dëshironi të kryeni për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të nxitur për një ESGJ më të mirë. Aktivitetet tuaja do të varen nga objektivat tuaja dhe nga situata në zonën ose vendin tuaj - ju do të keni një ide më të mirë se cilat janë aktivitetet më të përshtatshme që do të punojnë në kontekstin tuaj. Mos harroni se siguria dhe mirëqenia juaj duhet të jetë përparësia juaj kryesore. Para se të bëni ndonjë veprim, mendoni për rreziqet që mund të hasni, dhe mos tentoni ndonjë gjë që mund t'ju sjellë juve ose bashkëmohatarëve tuaj rrezikun e dëmtimit. Udhëzuesi i ECPAT International's (i listuar në seksionin Burimet) ka disa këshilla për të qëndruar të sigurt kur bëni avokim.

## Bëni disa kërkime mbi ESGJ në rajonin tuaj

- 🕒 Kontrolloni **Sondazhet Demografike dhe Shëndetësore** nga vendi juaj. Këto janë anketime të mëdha kombëtare, të cilat kërkojnë një sërë pyetjesh, por përfshijnë çështje si shëndeti, arsimi, moshja e marrëdhënies së parë seksuale, normat e shtatzënisë tek adoleshentët dhe më shumë. Ju mund të bëni tabela të këtij informacioni duke përdorur "**Stat Compiler**".
- 🕒 **Baza e të Dhënave për të Drejtat Seksuale** ka shumë informacione rreth ligjeve dhe politikave të ndryshme në mbarë botën lidhur me të drejtat dhe shëndetin seksual dhe riprodhues, duke përfshirë dhe edukimin seksual.
- 🕒 **Instituti Guttmacher** ndan hulumtimet e mbledhura për çështjet e shëndetit seksual anëmbanë botës, duke përfshirë një seksion mbi adoleshentët.
- 🕒 **Demistifikimi i të Dhënave** është një udhëzues për përdorimin e të dhënave për të mbrojtur shëndetin seksual dhe riprodhues të të rinjve dhe të drejtat e tyre. Në faqen e internetit ju keni një udhëzues avokimi, si dhe një dokument specifik, i cili liston shumë indikatorë të ndryshëm për të matur ESGJ.

## Krijoni faktet tuaja mbi ESGJ

- 🕒 Zhvilloni një studim për të rinjtë që të gjeni më shumë për atë që u është mësuar, ose intervistoni mësuesit dhe prindërit për njohuritë dhe qëndrimet e tyre ndaj ESGJ;
- 🕒 Përpiquni të merrni politikën e shkollës suaj ose programin mësimor mbi ESGJ, shëndetin ose mirëqenien për të parë se çfarë ka të mbuluar dhe çfarë jo;
- 🕒 Përdorni një mjet vlerësimi ESGJ (si ato në faqen 19) për të monitoruar dhe vlerësuar programet tuaja të ESGJ.



## Sigurori mbështetje për çështjen tuaj dhe ndërmerrni veprim!

- 🕒 Përdorni faktet tuaja për të shkruajtur një "letër informuese" mbi ESGJ e cila do të përshkruaj faktet për ESGJ dhe pse është i rëndësishëm për të rinjtë në vendin tuaj. Sigurohuni, gjithashtu, që të jepni disa rekomandime për atë që dëshironi të ndodhë dhe si mund të përmirësohet ESGJ. Ju mund ta shkruani këtë në bashkëpunim me një organizatë lokale që punon për shëndetin ose të rinjtë. Ju, gjithashtu, mund të organizoni një lançim publik për këtë letër duke sjellë së bashku vendimmarrësit dhe të rinjtë për të ndarë ekspertizën. Shihni për frymëzim broshurën e **Edukimit për Seksin në Mbretërinë e Bashkuar**.
- 🕒 Nëse ju jeni pjesë e një organizate, krijoni një deklaratë pozitive zyrtare mbi ESGJ. **Federata Ndërkombëtare e Shoqatave të Studentëve të Mjekësisë** (IFMSA) ka zhvilluar një deklaratë që ju mund ta përdorni si model.
- 🕒 Mbani një diskutim në panel publik mbi përfitimet e ESGJ dhe çfarë mungon në rajonin tuaj. Ju mund të ftoni të rinj dhe organizatat që punojnë për të rinjtë, edukimin ose shëndetin seksual dhe riprodhues dhe të drejtat, si dhe vendimmarrësit kryesorë dhe përfaqësuesit e medias, për të siguruar që diskutimi të ketë një shtrirje më të gjerë. Nëse keni akses në internet, krijoni një hashtag dhe shpërndajeni live diskutimin për ta hapur atë në një audiencë edhe më të madhe.
- 🕒 Angazhohuni me median duke ndarë artikuj dhe njoftime për shtyp në TV, radio dhe gazeta lokale / kombëtare. Mund të jetë e fuqishme për të rinjtë që të flasin publikisht për të drejtën e tyre ndaj edukimit seksual, por sigurohuni që jeni të sigurt për t'iu përgjigjur menjëherë pyetjeve të ndërlikuara! Përdorimi i mediave sociale është një mënyrë për të përhapur mesazhe edhe më tej. PACT në Tanzani ka prodhuar një **mjet të dobishëm** për t'u marrë me mediat, i cili mund të ndihmojë në shkrimin e njoftimeve për shtyp, pjesëmarrjen në intervista dhe më shumë.
- 🕒 Dokumenti i Institutit të Albert Ajnshtajnit, **"198 Metodat e Veprimit jo të Dhunshëm"**, jep 198 ide (po, vërtet!) se si të bëjmë avokim. Disa prej tyre janë metodat më tradicionale të mbuluara më sipër, por ato, gjithashtu, përfshijnë gjëra të tilla si përdorimi i artit (si piktura ose karikatura), muzika dhe teatri (si shkrimi i këngëve ose pjesë të performancës), marshime, parada, dhe të tjera.
- 🕒 **Amplify Change** (Ndryshim shumëfish) ka, gjithashtu, shumë ide të dobishme për aktivitete të ndryshme që mund të bëni për të përmirësuar ESGJ.
- 🕒 Mos harroni të angazhoheni me avokues tjetër të ESGJ në mbarë botën dhe të ndani veprimet dhe përvojat tuaja në **Qendrën e Avokimit të ESGJ** të zhvilluar nga UNFPA, UNESCO dhe IPPF!

## Hapi pesë: gjeni se çfarë ka funksionuar

Kur ne bëjmë avokaci është e rëndësishme të monitorojmë dhe të masim se çfarë ne po bëjmë, në mënyrë që të shikojmë se çfarë po funksionon dhe çfarë nuk po funksionon. Kjo bëhet në mënyrë që ne të mos vazhdojmë të japim kohë dhe përpjekje te diçka që nuk është e suksesshme. Ne mund të ndajmë njohuritë tona me të rinj të tjerë për t'i replikuar në zonat e tyre.

Kjo është arsyeja pse është kaq e rëndësishme të kemi objektiva SMART. Ju pastaj mund të kontrolloni veten nëse jeni duke i arritur objektivat tuaja brenda kornizës kohore. Kjo është edhe arsyeja pse ne zhvillojmë tregues (gjërat që masim në të gjithë planin e avokimit) për të parë se sa mirë po ecën. Kjo do të thotë se gjatë avokimit tuaj, ju duhet të masni progresin. Për shembull, sa prindër nënshkruan letrën tuaj të peticionit? Sa letra i keni dërguar deputetëve? Sa njerëz erdhën në mbledhjen tuaj publike? Sa pëlqime ka marë videoja juaj në Facebook? Dhe në fund të fundit - a ka rënë dakord shkolla, rajoni ose qeveria juaj për këtë ndryshim të madh në politikën apo programimin e CSE? Sigurohuni që ju të vazhdoni t'i referoheni kësaj gjatë gjithë planit tuaj. Për shembull, nëse synimi juaj ishte që të takoheni me dhjetë mësues gjatë vitit 2017, dhe deri në shtator ju keni takuar vetëm tre, shqyrtoni arsyet për këtë. A është objektivi juaj i arritshëm në radhë të parë? A janë mësuesit të gatshëm të takohen me ju për shkak të presionit nga drejtori? Çfarë mund t'ju ndihmojë të arrini këtë qëllim?

Është vërtet shumë e rëndësishme të mos ndiheni shumë të zhgënjyer nëse avokacia juaj nuk arrin qëllimin tuaj final, veçanërisht nëse qëllimi juaj është të ndryshoni politikën kombëtare ose për të ndikuar në qeverinë tuaj për t'u zotuar për diçka. Kjo është vërtet e vështirë për t'u bërë, dhe mund të marrë shumë vite, shumë kohë dhe para! Mendoni për gjërat e tjera që plani juaj ka arritur, për shembull takimet me liderët e shkollave ose ministrat e qeverisë, mbulimi në gazetatat lokale ose kombëtare, një rritje në mbështetjen nga prindërit për ofrimin e ESGJ në shkollën tuaj. Avokimi mund t'ju marrë shumë kohë, por çdo person, i cili ndryshon opinionin e tij ose merr një veprim bazuar në aktivitetet tuaja, duhet të konsiderohet një sukses.



# PËRBALLJA ME KUNDËRSHTARËT

Kudo që të jeni në botë, ka mundësi që fushatat tuaja për një ESGJ më të mirë do të hasin ndonjë rezistencë. Edhe pse e drejta e të rinjve për edukim mbështetet nga marrëveshja ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, organizma si Kombet e Bashkuara dhe organizatat globale bamirëse si IPPF, kjo nuk do të thotë që të gjithë individët bien dakord që kjo është një ide e mirë. Ndonjëherë ky kundërshtim ndaj ESGJ-së bazohet në keqinformimin ose në keqkuptimin e asaj që të rinjtë do të mësojnë, dhe për këtë arsye është e dobishme të dihet se çfarë mendojnë këta grupe për ESGJ, në mënyrë që ju të korrigjoni çdo informacion të rremë ose mashtrues dhe të përgatisni "argumentin kundër". Është gjithashtu, e rëndësishme të siguroheni, që në fillim, që ju jeni duke punuar së bashku me ata në komunitet, mësues dhe prindër dhe ndoshta udhëheqës fetarë, për të treguar se CSE kërkohet dhe nevojitet nga të rinjtë dhe se i ndihmon të rinjtë të jenë të shëndetshëm. Ky seksion jep disa shembuj të argumenteve të përbashkëta që njerëzit kanë kundër ESGJ-së dhe jep disa përgjigje që mund t'i jepni.

**Mësimi i të rinjve rreth seksit dhe seksualitetit i inkurajon ata të bëjnë më shumë seks, në një moshë më të re, dhe kështu çon në më shumë shtatzëni të paqëllimshme dhe SST.**

Në fakt, jo – të mësojmë të rinjtë rreth trupit të tyre, seksualitetit, dhe marrëdhënieve ka treguar të ketë një efekt "mbrojtjeje" në shëndetin dhe mirëqënien e tyre. Nuk ka prova që të tregojnë se marrja e ESGJ të çojë në një përvojë më të hershme seksuale, dhe madje mund të vonojë "debutimin seksual" (inkurajimi i të rinjve që të presin për të bërë seks derisa të jenë më të rritur). Përveç kësaj, ashtu siç tregojnë edhe provat në këtë manual, të rinjtë të cilët marrin një edukim cilësor mbi seksualitetin kanë më tepër predispozita për të përdorur prezervativ ose metoda të tjera kontraceptive, kur vendosin që të bëjnë seks, kanë më pak partnerë seksual, dhe kanë rritur njohuritë rreth prezervativëve dhe HIV-it.<sup>35</sup>

Prindërit nuk do të bien asnjëherë dakord që fëmijët e tyre të marrin edukim seksual në shkollë ose jashtë shtëpisë.

Pavarësisht kundërshtimit të zëshëm nga disa grupe që kundërshtojnë ofrimin e ESGJ në shkolla, prindërit në shumë pjesë të botës në fakt i mbështesin fëmijët e tyre për të mësuar rreth temave që kanë të bëjnë me shëndetin e tyre seksual dhe riprodhues. Një sondazh i UNESCO-s në Kinë, që i është bërë prindërve në internet zbuloi se 90% ishin në favor që fëmijët e tyre të mësonin për edukimin seksual, dhe të dhënat e vendeve në të cilat është kryer studimi në Afrikën Lindore dhe Jugore tregojnë se mbi 60% e të rriturve janë dakord që fëmijët duhet të marrin njohuri rreth prezervativëve.<sup>36</sup>

Fëmijët në shkollën fillore janë shumë të vegjë për të mësuar ESGJ.

Në një studim të Kombeve të Bashkuara gjatë vitit 2015, rezultoi se çerekut të vajzave u ka filluar cikli i menstruacioneve përpara se të kishin mundësi të mësonin për të në shkollë.<sup>37</sup> Përveç kësaj, 50% e tyre nuk kishin mësuar sesi të merrnin ndihmë për prekjet e padëshiruara ose abuzimin seksual.<sup>38</sup> Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë të mësojnë mbi çështjet që ndikojnë tek ata, dhe edukim të një cilësie të lartë, të përshtatshëm, sipas moshës nuk i dëmton ata, por mund t'i ndihmojë të bëjnë zgjedhje të informuara dhe të kuptojnë ndryshimet e trupit. Hulumtimet tregojnë se ESGJ për adoleshentët e hershëm (10-14 vjeç) është kritik, duke qenë se kjo moshë shënjon një pikë kyçe tranzicioni mes fëmijëve dhe adoleshentëve më të vjetër. Fëmijët do të marrin informacion, i cili lidhet me zhvillimin e tyre, të tillë si respekti, privatësia, miratimi, dhe kontrolli mbi trupin e tyre, që mund t'i ndihmojë ata të qëndrojnë të sigurt dhe të njohin dhe raportojnë abuzimet. Udhëzuesi Teknik Ndërkombëtar i UNESCO-s për edukimin seksual propozon një grup temash të përshtatshme për moshën nga pesë deri në tetëmbëdhjetë vjeç dhe Standardet për Edukimin Seksual në Evropë këshillojnë që ESGJ të fillojë që nga lindja. Siç kemi përmendur më parë, ESGJ nuk është vetëm për seksin, ai ka për qëllim të fuqizojë të gjithë njerëzit për të kuptuar dhe njohur trupat e tyre dhe për të na mundësuar të jetojmë jetë të lumtur dhe të shëndetshme.

Ne duhet t'u mësojmë fëmijëve që të mos bëjnë seks deri kur të martohen.

Jo çdonjëri do të zgjedhë që të martohet, dhe në shumë vende ka kufizime se kush është i aftë të martohet, për shembull ata që janë në marrëdhënie me seksin e njëjtë, pra edukimi që e supozon këtë është i padrejtë dhe joreal. Ka, gjithashtu, fakte që sugjerojnë se programet edukuese të cilat fokusohen në maturi (këshillimi i të rinjve që të mos bëjnë seks derisa të martohen) nuk jep informacionin që të rinjtë kanë nevojë për të negociuar në jetën reale dhe nuk prodhon rezultate të mira shëndetësore. Edukimi "Vetëm në maturi" ka rezultuar të jetë jo efektiv për parandalimin e HIV-it, rastet e infeksioneve seksualisht të transmetueshme, dhe shtatzënisë tek adoleshentët.<sup>39</sup>



**Edukimi seksual është një  
luku të cilin nuk duhet ta  
ofrojmë, ne duhet të  
shpenzojmë kohën dhe  
paratë tona në tema të tjera.**

ESGJ është pjesë e një edukimi të gjerë që të rinjtë marrin, për t'i ndihmuar ata të qëndrojnë të shëndetshëm dhe të sigurt dhe t'i mbështesim për t'u bërë qytetarë të mirëinformuar. Rezoluta 2012 për Adoleshentët dhe të Rinjtë nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë dhe Zhvillimin i bën thirrje qeverive të punojnë me të vërtetë me të rinjtë "t'u kushtojnë vëmendje të plotë përmbushjes së nevojave të të rinjve për shërbime të shëndetit riprodhues, informimin dhe edukimin e të rinjve, me respekt të plotë për privatësinë e tyre dhe konfidencialitetin, pa diskriminim dhe t'u ofrojë atyre arsimim gjithëpërfshirës të bazuar në fakte mbi seksualitetin njerëzor, shëndetin seksual dhe riprodhues, të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore, për t'u mundësuar atyre që të merren në mënyrë pozitive dhe të përgjegjshme me seksualitetin e tyre."<sup>40</sup> Programet e ESGJ mund të kenë vërtet shumë kosto efektive, veçanërisht kur janë të detyrueshme dhe të integruara në programin shkollor të zakonshëm – sepse të shpenzosh para për një ESGJ me cilësi të lartë kursen shpenzimet në të ardhmen në lidhje me shtatzënitë e paqëllimshme, HIV dhe IST e tjera. <sup>41</sup>ESGJ, gjithashtu, u ofron të rinjve aftësi të rëndësishme, të cilat i fuqizojnë ata për të bërë zgjedhjet e tyre në jetë.

**Si mund të justifikoni  
mësimin e të rinjve, që  
vijnë nga komunitetet  
fetare, për  
seksualitetin?**

Të gjithë të rinjtë të ndryshëm nga prejardhja dhe besimet kanë përvoja dhe pyetje rreth seksualitetit, ndryshimit të trupit dhe marrëdhëniet aktuale dhe të mëvonshme. Edhe pse ka grupe fetare dhe individë që kundërshtojnë ofrimin e ESGJ te të rinjtë, është gabim të supozojme se të gjithë grupet besimtare nuk do të mbështesin edukimin rreth këtyre temave. Shumë udhëheqës fetarë dhe anëtarë të komunitetit njohin rëndësinë që ka te të rinjtë dhënia e një informacioni të saktë, pa stigma rreth shëndetit dhe jetës së tyre seksuale në mënyrë që ata të jenë të lumtur, të sigurt dhe të shëndetshëm. Grupet e tilla si Katolikët për Zgjedhje dhe Koalicioni Fetar për Zgjedhjen Riprodhuese tregojnë se ekziston një mbështetje fetare për qasjen e të rinjve ndaj informacionit dhe shërbimeve në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre seksuale. Për shembull, në Kenia, një grup organizatash, që punonin për përgatitjen e një kurikule të re të ESGJ u goditën me kritika dhe reagime nga udhëheqësit fetarë dhe grupet e kishave në vend, të cilët thanë se kurikula e propozuar e ESGJ-së nxiti "devijimin nga morali seksual (imoralitet), abortin dhe devijimet seksuale". Në vend që të dekurajoheshin, grupet që avokonin për ESGJ më të mirë, u siguruan në angazhimin më të mirë të organizatave fetare dhe udhëheqësve fetarë, si dhe organizuan takime joformale për të gjetur një bazë të përbashkët për ndërtimin e një edukimi më të mirë seksual. Ata po inkurajojnë të flasin në shkolla, qeveri, kisha dhe xhami ata, që kanë parë efektet pozitive të ESGJ.<sup>42</sup>

# Burimet

Urojmë që ky manual t'ju ketë frymëzuar dhe motivuar për të bërë ndryshime për një ESGJ më të mirë në vendin ose rajonin tuaj, dhe ju ka dhënë disa ide sesi ju mund ta bëni këtë. Ka shumë mjete dhe dokumente me të vërtetë të dobishme të referuara në këtë broshurë, që do t'ju ofrojnë më shumë informacione dhe format për të hartuar dhe zbatuar strategjinë tuaj të avokimit.

## Burimet e The PACT

[ACT!2015 Advocacy Strategy Toolkit](#) (ky është në Anglisht,por mund të gjeni versionin në Frengjisht dhe Rusisht)

[Negotiation Brief on CSE](#) which situates CSE in the policy context and is useful for high level advocacy

[Guide to blog writing](#)

[Guide to developing a social media strategy](#)

[Guide to writing advocacy letters](#)

## Burime nga UNESCO

[Cost and Cost-Effectiveness Analysis of School-Based Sexuality Education Programmes in Six Countries](#)

[Levers of Success: Case Studies of National Sexuality Education Programmes](#)

[Comprehensive Sexuality Education: The Challenges and Opportunities of Scaling Up](#)

[Young People Today: Time to Act Now– why adolescents and young people need CSE and sexual and reproductive health services in Eastern and Southern Africa](#)

[Sexuality Education Review and Assessment Tool \(SERAT\)](#)

[SAFAIDS and UNESCO's toolkit for community members, Engaging Communities in CSE](#)

## Mjete Avokuese

[IPPF's guide to youth advocacy, 'Want to Change the World? Heres How...](#)

[IPPF's From Advocacy to Access: Targeted Political Action for Change](#)

[ECPAT International, Youth Power: A Manual on youth-led advocacy](#)

[YouACT's European Youth Advocacy Handbook](#)

[The CSE Advocacy Hub, developed by UNFPA with support from UNESCO and IPPF](#)

[Advocates For Youth Activists Toolkit](#)





### Informacione dhe Lexime të Mëtejshme

IPPF's 2016 report on CSE, "[Everyones Right to Know: Delivering Comprehensive Sexuality Education to All Young People](#)"

IPPF European Network's [Compendium on young peoples SRHR policies in Europe](#)

IPPF's guide, [Sustainable Development Goals: A SRHR CSO guide for national implementation](#)

UNFPA and WHO's [Sexuality Education Policy Brief No. 1 \(what is sexuality education?\)](#)

UNFPA and WHO's [Sexuality Education Policy Brief No. 2 \(what is the impact of sexuality education?\)](#)

UNFPA's [Evaluation of Comprehensive Sexuality Education Programmes, focusing on gender and empowerment outcomes](#)

UNFPA's [Operational Guidance for Comprehensive Sexuality Education](#)

The UK Sex Education Forum's brief on the evidence for comprehensive sexuality education, [SRE - the evidence](#)

Rutgers' [Explore: monitoring and evaluation and research in SRHR Programmes for Young People](#)

[Demographic and Health Surveys](#) and the [Stat Compiler](#)

[Sexual Rights Database](#)

[Guttmacher Institute's](#) data on teens and adolescents's sexual and reproductive health and rights, including sexuality education

Guttmacher Institute and IPPF's [Demystifying Data](#)

[Inside and Out: Comprehensive Sexuality Education Assessment Tool](#) by IPPF which can assess CSE in and out of school

### Udhëzime Globale për ESGJ

[United Nations International Technical Guidance on Sexuality Education \(2009\)](#)

[WHO's Standards for Sexuality Education in Europe](#)

# Referenca

- <sup>1</sup> UNESCO, 2015. Emerging Evidence, Lessons and Practice in Comprehensive Sexuality Education: A Global Review.
- <sup>2</sup> United Nations Department of Economic and Social Affairs. Definition of Youth.
- <sup>3</sup> IPPF, 2016. Everyone's Right to Know Delivering Comprehensive Sexuality Education to All Young People.
- <sup>4</sup> Ibid.
- <sup>5</sup> UNESCO, 2016. Being a Young Person: Comprehensive Sexuality Education (Video).
- <sup>6</sup> UNESCO, 2015. Emerging Evidence, Lessons and Practice in Comprehensive Sexuality Education: A Global Review
- <sup>7</sup> UNESCO, 2009. International Technical Guidance on Sexuality Education.
- <sup>8</sup> IPPF, 2011. Exclaim! Young People's Guide to 'Sexual Rights: an IPPF Declaration'.
- <sup>9</sup> UNESCO, 2015. Emerging Evidence, Lessons and Practice in Comprehensive Sexuality Education: A Global Review.
- <sup>10</sup> Holden, J., Bell, E. & Schauerhammer, V., 2015. we want to Learn About Good Love: Findings from a Qualitative Study Assessing the Links Between Comprehensive Sexuality Education and Violence Against women and Girls.
- <sup>11</sup> UNESCO, UNESCO Institute of Statistics, Global Education Monitoring Report, 2016. Leaving no one behind: How far on the way to universal primary and secondary education?
- <sup>12</sup> Stonewall, 2012. The School Report: The experiences of young gay people in Britain's schools in 2012.
- <sup>13</sup> UNESCO, 2015. Emerging Evidence, Lessons and Practice in Comprehensive Sexuality Education: A Global Review.
- <sup>14</sup> UNESCO and UNFPA, 2012. Sexuality Education: A ten-country review of school curricula in East and Southern Africa.
- <sup>15</sup> IPPF, 2011. want to Change the world? Here's How.
- <sup>16</sup> UNESCO, 2015. Emerging Evidence, Lessons and Practice in Comprehensive Sexuality Education: A Global Review.
- <sup>17</sup> Ibid.
- <sup>18</sup> Ibid.
- <sup>19</sup> Ibid.
- <sup>20</sup> Ibid.
- <sup>21</sup> UNICEF, 2012. Peer Education fact sheet.
- <sup>22</sup> IPPF, 2016. Everyone's Right to Know: Delivering Comprehensive Sexuality Education to All Young People.
- <sup>23</sup> Holden, J., Bell, E. & Schauerhammer, V., 2015. we want to Learn About Good Love: Findings from a Qualitative Study Assessing the Links Between Comprehensive Sexuality Education and Violence Against women and Girls.

- <sup>24</sup> UNESCO, 2015. Emerging Evidence, Lessons and Practice in Comprehensive Sexuality Education: A Global Review
- <sup>25</sup> IPPF, 2012. Keys to youth-friendly services: Understanding evolving capacity.
- <sup>26</sup> IPPF, 2011. Keys to youth-friendly services: Adopting a sex positive approach.
- <sup>27</sup> UNESCO, 2015. Emerging Evidence, Lessons and Practice in Comprehensive Sexuality Education: A Global Review
- <sup>28</sup> Ibid.
- <sup>29</sup> Ministerial Commitment on comprehensive sexuality education and sexual and reproductive health services for adolescents and young people in Eastern and Southern Africa (ESA).
- <sup>30</sup> Economic Commission for Latin America and the Caribbean, 2013. Montevideo Consensus on population and development.
- <sup>31</sup> United Nations General Assembly, 2016. Political Declaration on HIV and AIDS: On the Fast-Track to Accelerate the Fight against HIV and to End the AIDS Epidemic by 2030.
- <sup>32</sup> Rutgers, 2013. Explore: Monitoring and evaluation and research in SRHR programmes for young people.
- <sup>33</sup> UNESCO, 2013. Sexuality Education Review and Assessment Tool (SERAT).
- <sup>34</sup> IPPF, 2015. Inside and Out: Comprehensive Sexuality Education Assessment Tool.
- <sup>35</sup> UNESCO, 2015. Emerging Evidence, Lessons and Practice in Comprehensive Sexuality Education: A Global Review
- <sup>36</sup> Ibid.
- <sup>37</sup> Sex Education Forum, 2016. 1 in 4 girls start their periods before learning about it at school.
- <sup>38</sup> National Children's Bureau and Sex Education Forum, 2016. Heads or Tails? What young people are telling us about SRE.
- <sup>39</sup> IPPF, 2016. Everyone's Right to Know: Delivering Comprehensive Sexuality Education to All Young People.
- <sup>40</sup> Commission on Population and Development, 2012. Resolution 2012/1 on Adolescents and Youth.
- <sup>41</sup> UNESCO, 2011. Cost and Cost-Effectiveness Analysis of School-Based Sexuality Education Programmes in Six Countries.
- <sup>42</sup> Rutgers, 2016. Joint Advocacy for Comprehensive Sexuality Education in Kenya.



### **Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin**

Bulevardi “Gjergj Fishta”,  
Kompleksi Tirana 2000”, Kulla 4. Tiranë

Tel: +355 42 251475,

E-mail: [info@acpd.org.al](mailto:info@acpd.org.al);

Website : <http://acpd.org.al>

Facebook: <https://www.facebook.com/ACPD-137027623620912>

Twitter: [https://twitter.com/ACPD\\_Albania](https://twitter.com/ACPD_Albania)